2026,2027,2028			Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Bashkia Shkodër Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike				

Nr.15	P.AI141.Q1.O1.A15. Materiale mbështetëse për arsimin parashkollor. (materiale të tjera, materiale pastrimi dhe pajisje orendi).	AI141. Arsimi					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i.Situata							
Për të krijuar kushte sa më të përshtatshme higjienike për vitin 2026, kemi hartuar një përmbledhje të materialeve që do të mundësojnë mbajtjen e ambienteve parashkollore në kushte normale higjienike. Gjatë përpilimit të shpenzimeve për këtë zë është marrë parasysh numri i fëmijëve dhe i kopshteve. Materialet do t'u shërbejnë kopshteve të qytetit dhe njësive administrative. Një zë i rëndësishëm për të gjitha kopshtet e qytetit dhe njësive administrative është blerja e materialeve të pastrimit. Çdo vit është e nevojshme të blihen detergjentë, dezinfektantë dhe mjete të tjera për pastrim. Gjithashtu, për nevojat e kopshteve janë të domosdoshme pajisje dhe orendi të tjera, si krevate për fjetje, karrige dhe tavolina, enë kuzhine, batanije, çarçafë, jastekë, peshqirë etj. Për blerjen e pajisjeve, është e nevojshme të sigurohen gjithashtu: kaloriferë, kondicionerë, fshesa elektrike, lavatrice, shporet për gatim etj.							
ii.Synimi i projektit							
- Të krijohen kushte optimale për rritje në cilësisë së shërbimit në ambientet parashkollore. - Të menaxhohen me efikasitet fondet për arsimin parashkollor dhe krijimi i mundësive për një zhvillime shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve parashkollore në të gjithë territorin Bashkisë Shkodër. - Përmirësimi i plotësimit të nevojave aktuale për rritjen e cilësisë së shërbimit (shërbimi i ofruar/shërbimin e kërkuar nga ana e drejtuesit të kopshteve)							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
- Unifikimi i kërkesave të mjeteve të punës - Vlerësim i kërkesave në përputhje me kapacitetet - Kryerja e procedurave përkatëse. - Monitorimi i procesit të furnizimit.							
b)Rezultatet që prisni							
- Realizimi i shërbimit të furnizimit me materiale për krijimin e kushteve të përshtatshme në të gjitha ambiente të objekteve parashkollore. - Krijimi i kushteve optimale të punës për edukatorët dhe fëmijët gjatë procesit mësimor dhe edukativ.							
c) Aktorë të mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt			
Fëmijë të kopshteve dhe stafi				Bashkia Shkodër			
e)Shpenzime të llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pikave))							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale për pastrim, dezinfektim etj.	700			700		
A.2	Blerje materiale të ndryshme	840			840		
A.3	Blerje pajisje (orendi)	4,000					4,000
Shuma		5,540			1,540		4,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për arsimin parashkollor	6,000			2,000		4,000
Shuma		6,000			2,000		4,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për arsimin parashkollor	6,000			2,000		4,000
Shuma		6,000			2,000		4,000
f)Perioda e zbatimit 2026,2027,2028		g)Përgatiti dhe ndjek realizimi në projekt: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike					

Nr.16	P.A1141.Q1.O1.A16. Materiale mbështetëse për arsimin parashkollor, kancelari.	A1141. Arsimi					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i.Situata							
Për zhvillimin e metodikave mësimore dhe për mbarrëvajtjen e punës, kërkohet furnizimi me materialet kancelarike në kopshte. Për këtë, është parashikuar blerja e materialeve kancelarike, si letra formati A4, fletore pune dore, bojra për ngjyrosje, goma, stilolapsa, vizore, plastelinë etj.							
ii.Synimi i projektit							
- Të krijohen kushte optimale për rritjen e cilësisë së shërbimit në ambientet parashkollore. - Të menaxhohen me efikasitet fondet për arsimin parashkollor dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve parashkollore në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. - Përmirësimi i plotësimit të nevojave aktuale për rritjen e cilësisë së shërbimit (shërbimi i ofruar/shërbimin e kërkuar nga ana e drejtuesit të kopshteve)							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
- Unifikimi i kërkesave të mjeteve të punës - Vlerësimi i kërkesave në përputhje me kapacitetet - Kryerja e procedurave përkatëse - Monitorimi i procesit të furnizimit.							
b)Rezultatet që prisni							
- Realizimi i shërbimit të furnizimit me materiale për krijimin e kushteve të përshtatshme në të gjitha ambientet e objekteve parashkollore. - Krijim i kushteve optimale të punës për edukatorët dhe fëmijët gjatë procesit mësimor dhe edukativ.							
c) Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme nëprojekt			
Fëmijë te kopshteve dhe stafi				Bashkia Shkodër			
e)Shpenzime te llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm(pikai i i)							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Materiale mbështetëse për arsimin parashkollor kancelari	219			219		
	Shuma	219			219		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Materiale mbështetëse për arsimin parashkollor kancelari	219			219		
	Shuma	219			219		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Materiale mbështetëse për arsimin parashkollor kancelari	219			219		
	Shuma	219			219		
f)Periodha e zbatimit		g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
2026,2027,2028		Bashkia Shkodër.					
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.17	P.AI141.Q1.O1.A17. Ngrohje dhe gatim me lëndë djegëse (dru zjarri, dru pelet, naftë dhe gaz) për arsimin parashkollor	AI141. Arsimi					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i.Situata							
Në të gjitha kopshtete territorit të Bashkisë Shkodër, përdoren burime të ndryshme energjie për ngrohje, si energjia elektrike, dru zjarri dhe pelet. Në kopshte me ushqim, në qytet përdoret gjithashtu gaz për gatim, dru zjarri për ngrohje, dhe në disa kopshte energjia elektrike. Më poshtë, është përshkruar mënyra e ngrohjes për secilin kopsht:							
Kopshtet që ngrohen me energji elektrike:							
- Kopshti "Ismet Sali Bruçaj" (Soros) - Kopshti "Njomëzat" - Kopshti "Xixëllonjat" (tek ish-Veterinarja) - Kopshti "Bep Tusha" (për momentin ngrohet me energji elektrike, ndërkohë që sistemi i ngrohjes me kaldajë me naftë është jashtë funksionit) - Kopshtet në Njësitë Administrative (përdorin energji elektrike për ngrohje)							
Kopshtet që ngrohen me dru zjarri:							
- Kopshti "Ton Alimhilli" - Kopshti "Edit Durham" - Kopshtet në Njësitë Administrative (përdorin shporetë me dru për ngrohje)							
Kopshtet që ngrohen me pelet:							
Kopshti "Ngjyrat" (përdor kaldajë me pelet për ngrohje)							
Kopshtet që përdorin gaz për gatim:							
- Kopshti "Ismet Sali Bruçaj" (Soros) - Kopshti "Ton Alimhilli" - Kopshti "Bep Tusha" - Kopshti "Ngjyrat" - Kopshti "1 Qershori" - Kopshti "Edit Durham" - Kopshti "Njomëzat" - Kopshti "Xixëllonjat"							
ii.Synimi i projektit							
- Të menaxhohen me efikasitet fondet për arsimin parashkollor dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve parashkollore në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Sigurimin e ofrimit të këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për këto objekte parashkollore. - Përmirësimi i shërbimit të ngrohjes në Kopshte. - Përmirësim i plotësisht të nevojave aktuale për rritjen e cilësisë së shërbimit të ushqimit në kopshte.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
- Procedurat për verifikimin e nevojave për shërbim në kopshte - Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime; - Realizimi i procedurave të prokurimit për blerjen e druve të zjarrit; - Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit, sipas planifikimit; - Monitorim dhe raportimi aktivitetit mujor për realizimin e projektit;							
b)Rezultatet që prisni							
Realizimin e shërbimit të furnizimit me dru zjarri, gaz dhe naftë për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme në të gjitha objektet parashkollore.							
c) Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt			
Fëmijët parashkollorë dhe stafi edukativ				Bashkia Shkodër			
e)Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Lëndë djegëse (dru zjarri)	2,200			2,200		
A.2	Lëndë djegëse (gaz)	300			300		
A.3	Lëndë djegëse (Pelet)	500			500		

	Shuma	3,000			3,000		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Lëndë djegëse (dru zjarri)	2,200			2,200		
A.2	Lëndë djegëse(gaz)	300			300		
A.3	Lëndë djegëse (Pelet)	500			500		
	Shuma	3,000			3,000		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferi me	Kapitale
A.1	Lëndë djegëse (dru zjarri)	2,200			2,200		
A.2	Lëndë djegëse (gaz)	300			300		
A.3	Lëndë djegëse (Pelet)	500			500		
	Shuma	3,000			3,000		
f) Periudha e zbatimit 2026,2027,2028		g)Përgatiti dhe ndjek realizimi ne projektit: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike					

Nr.18	P.AI141.Q1.O1.A18. Sigurimi i objekteve të arsimit parashkollor (siguracioni i ndërtësës)	AI141. Arsimi				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
Bashkia e Shkodrës duhet të sigurojë mirëfunksionimin e një numri të madh kopshtesh, të cilat kërkojnë vëmendje të veçantë. Bazuar në: - Ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 23, Funksionet e bashkivenëfushën e infrastrukturës dheshërbimevepublike, pika 11, qëpërcakton "Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale." - Ligjin Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar, dheUdhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktivevenë Njësitë e Sektorit Publik", Kreu IV, pika 74, I ndryshuar. Ndërtesat e sistemit arsimor parashkollor duhet të sigurohen njëherë në vit. Për këtë arsye, është planifikuar një vlerë e caktuar për sigurimin e ndërtesave, që do të përdoret për këtë qëllim.						
ii.Synimi i projektit						
Të përfitojmë shërbimin për sigurimin e ndërtesave për çdo ngjarje të jashtëzakonshme.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
✓ Marrjen e kërkesave për secilin institucion. ✓ Vlerësimi i kërkesave në përputhje me kapacitetet ✓ Kryerja e procedurave përkatëse ✓ Monitorimi i procesit						
b)Rezultatet që prisni						
Krijimi i kushteve optimale të punës për edukatorët dhe fëmijet gjatë procesit të edukativ dhe formimit.						
c) Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt		
Objektet publike				Bashkia Shkodër		
e)Shpenzime të llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm(pikaiii))						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për sigurimin e ndërtesave	80			80	
	Shuma	80			80	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për sigurimin e ndërtesave	80			80	
	Shuma	80			80	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për sigurimin e ndërtesave	80			80	
	Shuma	80			80	
f)Periudha e zbatimit 2026,2027,2028		g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike				

Nr.19	P.AI141.Q1.O1.A19. Dezinfektim i mjediseve të objekteve në arsimin parashkollor.		AI141. Arsimi				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i.Situata							
Për të siguruar ambiente higjienike dhe të mbrojtura ndaj infektiveve, është e domosdoshme dezinfektimi i ambienteve të godinave parashkollore. Bashkia Shkodër realizon dezinfektimin e godinave të kopshteve disa herë në vit, sipas nevojës, duke përfshirë edhe raste emergjente kur është e nevojshme. Ky proces realizohet me fondet e dedikuara nga Bashkia Shkodër.							
ii.Synimi i projektit							
Të krijohen kushte optimale për rritje në cilësi dhe sigurisë në ambiente të kopshteve.Ofrimin e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për këto objekte parashkollore.							
iii.Aktivitetet kryesore të projektit							
- Ndërtimi i kalendarit të dezinfektimit. - Vlerësimi i kërkesave në përputhje me kapacitetet - Kryerja e procedurave përkatëse - Monitorimi i procesit të shërbimit							
b)Rezultatet që prisni							
Fëmijët në institucionet parashkollore të kenë kushte higjieno-sanitare të sigurta gjatë procesit të edukimit, mirërritjes dhe formimit.							
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt			
Fëmijët,staffi dhe Inspektoriati HigjienoSanitar.				Bashkia Shkodër			
e)Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shërbime për dezinfektim	60			60		
	shuma	60			60		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shërbime për dezinfektim	60			60		
	Shuma	60			60		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mijë lekë)	Ngakjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shërbime për dezinfektim	60			60		
	Shuma	60			60		
f)Periudha e zbatimit 2026,2027,2028			g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike				

Nr.20	P.AI141.Q1.O1.A20. Furnizim me EE dhe ujë për arsimin parashkollor	AI141. Arsimi					
a)Përshkrimi I shkurtër I projektit:							
i.Situata							
Bashkia Shkodër mbështet me shërbime funksionimin e kopshteve në territorin e saj. Synojmë që të furnizojmë të gjitha kopshtet me energji elektrike dhe ujë pa ndërprerje. Edhe në ato kopshte ku janë evidentuar probleme, në vitin 2026 do të angazhohemi për të siguruar këto shërbime në mënyrë të vazhdueshme. Megjithatë, është e nevojshme një shtesë e fondeve, pasi plani i parashikuar për energjinë elektrike është konsumuar plotësisht çdo vit. Shërbimet e energjisë elektrike dhe ujit realizohen nga OSHEE dhe UKSH. Për secilin objekt lidhen kontrata të veçanta për shërbimin dhe, në vazhdim, sipas monitorimit dhe akteve të rakordimit, vijon pagesa e tyre. Planifikimi për vitin 2026 parashikon financimin e këtyre shërbimeve, duke u bazuar në historikun e administrimit të viteve të fundit dhe duke adresuar problemet e evidentuara.							
ii.Synimi i projektit							
- Furnizimi me energji elektrike dhe ujë për të gjitha objektet parashkollore në territorin e Bashkisë Shkodër. - Ofrimin e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për këto objekte parashkollore.							
iii.Aktivitetet kryesore të projektit							
- Rishikimi i kontratave ekzistuese dhe lidhje ne kontratave te reja, për ato objekte parashkollore që kanë probleme - Kolaudimin e matësve si dhe rakordimin sistematik me OSHEE. - Monitorimin e vazhdueshëm të shpenzimeve të energjisë në të gjitha objektet parashkollore. - Likuidim e vetë detyrimit sipas shpenzimit të energjisë së ujit dhe energjisë elektrike.							
b)Rezultatet që prisni							
- Furnizim me ujë të pijshëm në të gjitha kopshtet në territorin e Bashkisë së Shkodrës - Furnizim me energji elektrike në të gjitha kopshtet në Bashkinë Shkodër.							
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontribute te mundshme në projekt			
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike OSHEE Ujësjellës Kanalizime				Bashkia Shkodër			
e)Shpenzime te llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Energji elektrike	2,200			2,200		
A.2	Furnizimi me ujë	1,000			1,000		
	Shuma	3,200			3,200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Energji elektrike	2,200			2,200		
A.2	Furnizim me ujë	1,000			1,000		
	Shuma	3,200			3,200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Energji elektrike	2,200			2,200		
A.2	Furnizimi me ujë	1,000			1,000		
	Shuma	3,200			3,200		
f)Periodha e zbatimit		g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
2026,2027,2028		Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike					
		Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike					

Nr.21	P.AI141.Q1.O1.A21. Sigurimi i transportit për shërbimet e arsimit parashkollor.	AI141. Arsimi					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i.Situata							
Për shpërndarjen e ushqimeve çdo ditë në 7 kopshte me drekë, janë të nevojshme shpenzimet e transportit. Për këtë qëllim, disponojmë një mjet frigoriferik të posaçëm dhe personelin e angazhuar për të kryer shërbimin. Në buxhetin e vitit 2026, planifikojmë shpenzimet e domosdoshme për karburantin, siguracionin, kolaudimin dhe taksat vjetore të automjetit, si dhe shërbimet e automjetit.							
ii.Synimi i projektit							
- Sigurimi i shpërndarjes, furnizimit ditor të ushqimit për Kopshtet me drekë. - Mirëmbajtje e mjetit dhe taksat vjetore.							
iii.Aktivitetet kryesore të projektit							
- Pagesa e taksës vjetore për mjetin frigoriferik që transporton ushqimin ditor në kopshte. - Shpërndarja e ushqimit në orarin e duhur në të gjitha kopshtet me drekë. - Mirëmbajtja me kanike e furgonit frigoriferik, në bazë të nevojave të amortizimit.							
b)Rezultatet që prisni							
Shpërndarja e ushqimit në orarin dhe standartin e duhur në të gjitha kopshtet me drekë.							
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt			
Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike				Bashkia Shkodër			
e)Shpenzime te llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për karburant	300			300		
A.2	Shpenzime për mirëmbajtje të automjetit	200			200		
A.3	Shpenzime të tjera të automjetit (taksa, siguracion, kolaudim)	150			150		
	Shuma	650			650		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për karburant	300			300		
A.2	Shpenzime për mirëmbajtje të automjetit	300			300		
A.3	Shpenzime të tjera të automjetit (taksa, siguracion, kolaudim)	50			50		
	Shuma	650			650		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për karburant	300			300		
A.2	Shpenzime për mirëmbajtje të automjetit	300			300		
A.3	Shpenzime të tjera të automjetit (taksa, siguracion, kolaudim)	50			50		
	Shuma	650			650		
f)Periodha e zbatimit 2026,2027,2028			g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike				

Nr.22	P.AI141.Q1.O1.A22. Furnizim me ushqime për kopshtet në Bashkinë e Shkodrës	AI141. Arsimi					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i.Situata							
Në Bashkinë Shkodër janë në funksion 7 kopshte me drekë: - Kopshti "Ismet Sali Bruçaj" (Soros) ka 127 fëmijë të regjistruar. - Kopshti "Bep Tusha" ka 86 fëmijë të regjistruar. - Kopshti "Ton Alimhilli" ka rreth 109 fëmijë të regjistruar. - Kopshti "Guerrile" (Ngjyrat) ka 60 fëmijë të regjistruar. - Kopshti "1 Qershori" ka 25 fëmijë të regjistruar me ushqim. - Kopshti "Edit Durham" ka 33 fëmijë të regjistruar me ushqim. - Kopshti "Njomëzat" ka 60 fëmijë të regjistruar me ushqim. Në total, në kopshtet me drekë janë të regjistruar 500 fëmijë, të cilët marrin 4 vakte në ditë. Për ushqyerjen e fëmijëve, përgatitet menuja ditore sipas normativave të përcaktuara. Përllogaritet vlera dhe specifikimet teknike për artikujt ushqimorë, dhe vijon procedura e prokurimit dhe realizimi i shërbimit. Kuota ditore përllogaritet, sipas paketës fiskale dhe parashikimi bëhet për një frekuentim mesatarisht 400 fëmijë në ditë, ndër të cilët 45 parashikohet të subvencionohet nga Bashkia Shkodër sipas VKB-së nr. 25 datë 20.12.2019 "Për disa ndryshime në VKB nr. 1 datë 22.01.2016 "Për taksat dhe tarifat vendore", III.4.8.1 (Përjashtime).							
ii.Synimi i projektit							
Ofrimi i shërbimit në standart për sigurimin e mirërritjes së fëmijëve në kopshtet me drekë.							
iii.Aktivitetet kryesore të projektit							
Vlerësimi i nevojave Përllogaritja sipas artikujve e fondit limit të prokurimit Realizimi I procedurave të prokurimit publik Realizimi i shërbimit Monitorimi i shërbimit Likuidimi i detyrimeve kontraktuale për shërbimin e realizuar.							
b)Rezultatet që prisni							
Mirë rritje e fëmijëve në kopshtet në Bashkinë Shkodër.							
c)Aktorët e mundshëm			d)Kontribute te mundshme në projekt				
Prindërit Fëmijët			Prindërit				
e)Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Furnizim me ushqime	14,995			14,995		
	Shuma	14,995			14,995		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Ngakjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Furnizim me ushqime	14,995			14,995		
	Shuma	14,995			14,995		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Furnizim me ushqime	14,995			14,995		
	Shuma	14,995			14,995		
f)Periodha e zbatimit		g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
2026,2027,2028		Bashkia Shkodër Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.23	P.AI141.Q1.O1.A23. Mirëmbajtje e zakonshme për ndërtesat e arsimit parashkollor.	AI141. Arsimi				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
Ndërtesat e sistemit arsimor parashkollor, për të qenë sa më të përshtatshme dhe komode për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve, kanë nevojë për mirëmbajtje, si p.sh. lysterje me bojë dhe riparime të ndryshme. Në territorin e Bashkisë Shkodër ka gjithsej 51 kopshte, me një sipërfaqe totale prej 6872 m², ku duhen realizuar mirëmbajtje minimale, përfshirë lysterjen. Kopshtet në qytet me drekë kanë këto sipërfaqe: - Kopshti “Ismet Sali Bruçaj” (Soros): 450 m² + oborr 900 m² - Kopshti “Guerrile” (Ngjyrat): rreth 350 m² - Kopshti “Edit Durham”: rreth 450 m² - Kopshti “Njomëzat”: rreth 500 m² Ndërsa Kopshti Bep Tusha dhe Ton Alimhilli janë në proces rikonstruksioni të plotë, gjithashtu dhe Kopshti 1 Qershori që ndodhet Brenda shkolles Kole Idromeno që është në rikonstruksion. Kopshtet në njësitë administrative (periferi) të Bashkisë Shkodër do të trajtohen sipas prioriteteve.						
Plani i mirëmbajtjes për vitin 2026 parashikon:						
- Lysterje me bojë për të gjitha kopshtet me drekë, si dhe për ambientet e brendshme të kopshteve pa drekë, aty ku vlerësohet se është më e nevojshme. - Kopshtet në Njësitë Administrative, ku ngrohja është me dru, gjithashtu përfshihen në planin e mirëmbajtjes.						
Përmirësime të tjera të parashikuara:						
- Lysterje me bojë dhe eliminimi i lagështirës dhe mykut në kopshte të caktuara, si Kopshti Fetah Barbullushi dhe kopshte të tjera si Drisht, Dragoc, Kullaj dhe Myselim. - Mirëmbajtje e dyerve, dritareve dhe tualeteve për kopshte si Ismet Sali Bruçaj, Liria, Ajasëm, Pashko Vasa, Edit Durham, Nikollë Zagorjani, Fetah Barbullushi, Dragoc dhe Drisht etj.						
ii.Synimi i projektit						
Ofrimi i këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për këto objekte parashkollore, I domosdoshëm për përmirësimin e kushteve në institucionet e arsimit parashkollor						
iii.Aktivitetet kryesore të projektit						
- Vlerësimi dhe përditësimi i nevojave për shërbim në kopshte - Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime; - Realizimi i procedura vetë prokurimit; - Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit, sipas planifikimit; - Monitorim dhe raportim i zbatimit të punimeve - Likuidim i shërbimit të kryer.						
b)Rezultatet që prisni						
Realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së ambienteve të godinave parashkollore.						
c) Aktorët e mundshëm			d)Kontributet e mundshme në projekt			
Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike			Bashkia Shkodër			
e)Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Shërbime për mirëmbajtje të objekteve ndërtimore	10,000			10,000	
	Shuma	10,000			10,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë	Nga kjo:			

		lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Shërbime për mirëmbajtje të objekteve ndërtimore	10,000			10,000		
	Shuma	10,000			10,000		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Shërbime për mirëmbajtje të objekteve ndërtimore	10,000			10,000		
	Shuma	10,000			10,000		
f) Periudha e zbatimit 2026,2027,2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimi ne projektit: Drejtorja e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Institucioni likuidues: Drejtorja e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike					

Nr.24		P.AI141.Q1.O1.A24. Shpenzime për kalibrim Kaldaje		AI141. Arsimi		
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
Kopshti "Ngjyrat" siguron ngrohejn me kaldaje për këtë është i nevojshëm kalibrimi çdo vit për të siguruar funksionimin e tij të përshtatshëm.						
ii.Synimi i projektit						
Synohet plotësimi i nevojave emergjente dhe të nevojshme për mirëmbajtjen e aparateve dhe pajisjeve teknike që të jenë përherë në gjendje pune.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Frigoriferëve, lavatriceve,aristonëve, kompjuterave etj që lidhen me funksionin normal të punës.						
b)Rezultatet që prisni						
Realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së aparateve dhe pajisjeve teknike						
c) Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt		
Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike				Bashkia Shkodër.		
e)Shpenzime te llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm(pikaiii))						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për kalibrim Kaldaje	125			125	
	Shuma	125			125	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për kalibrim Kaldaje	125			125	
	Shuma	125			125	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për kalibrim Kaldaje	125			125	
	Shuma	125			125	
ff)Periudha e zbatimit 2026,2027,2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimi ne projektit: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike				

Nr.25	P.A1141.Q1.O1.A25. Mbështetje e fëmijëve në nevojë për përjashtim nga tarifa e pagesës.	A1141. Arsimi
a)Përshkrimi i shkur të ri projektit:		
i.Situata		
Në kuadër të politikave sociale që zbaton Bashkia Shkodër, për gjithëpërfshirjen dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë individët dhe familjet në nevojë, sipas VKB-së nr. 25 datë 20.12.2019 "Për disa ndryshime në VKB nr. 1 datë 22.01.2016 "Për taksat dhe tarifat vendore", III.4.8.1 (Përjashtime) është propozuar dhe miratuar reduktimi ose shërbimi pa pagesë në kopsht dhe çerdhe te disa kategorive sipas kriterëve dhe procedurës së përcaktuar më poshtë:		
Përfitojnë reduktim të detyrimit mujor ose shërbim pa pagesë në kopsht/çerdhe kategoritë si më poshtë:		
• Familjet në nevojë, si më poshtë: ○ Fëmijë të familjeve pa të ardhura ose me të ardhura shumë të ulta, ku përfshihen edhe familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, sipas të dhënave të publikuara në mënyrë periodike nga INSTAT. ○ Fëmijë të familjeve ku njëri prej prindërve ose të dy prindërit janë me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, sipas vlerësimit të Komisionit Mjeko-Ligjor, dhe të ardhurat janë deri në nivelin e pagës minimale të miratuar (ku nuk përfshihen të ardhurat nga ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë). ○ Fëmijët e familjeve ku kryefamiljare është gruaja e ve, sipas certifikatës të gjendjes familjare, familjet një prindërore, dhe familjet ku kryefamiljare është gruaja që është viktimë e dhunës në familje (me Urdhër Mbrojtje), por që kanë të ardhura deri në nivelin e pagës minimale të miratuar.		
Në kuadër të politikave sociale që zbaton Bashkia Shkodër, për gjithëpërfshirjen dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë individët dhe familjet në nevojë, mbështesim rritjen e përfshirjes dhe integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në çerdhe dhe kopshte.		
Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak të shtesës së buxhetit me fondin e miratuar nga Ministria e Financave, Bashkia Shkodër do të fillojë procesin e rekrutimit të mësuesve ndihmës për arsimin parashkollor.		
Kriteret, procedurat, dokumentacioni i nevojshëm dhe mekanizmi i subvencionimit për të përfituar shërbim pa pagesë në kopsht/çerdhe edhe për këtë kategori është duke u diskutuar nga disa drejtori të bashkisë, duke vendosur një sistem pikëzimi uniform me lehtësitë fiskale ekzistente (duke përcaktuar nivelin e të ardhurave deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi, ku nuk përfshihen të ardhurat nga ndihma ekonomike apo pagesa e paaftësisë).		
Për të përfituar nga reduktimi ose përjashtimi nga detyrimi mujor në kopsht dhe çerdhe, duhet të aplikohet në Zyrën me një ndalesë, dhe pas vlerësimit social ekonomik të rastit nga specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, dërgohet për miratim pranë kryetarit të Bashkisë, në vazhdim referohet për regjistrim pa tarifë pranë çerdes/kopshtit përkatës.		

Për ushqyerjen e fëmijëve përgatitet menuja ditore sipas normativave të përcaktuara, përllogaritet vlera dhe specifikimet teknike për artikujt ushqimorë, vijohet me procedurën e prokurimit dhe realizimin e shërbimit.							
ii. Synimi i projektit							
Reduktimi/ shërbimit pa pagesë në çerdhe për fëmijët e familjeve në nevojë në Shkodër, me qëllim gjithëpërfshirjen dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë individët dhe familjet në nevojë .							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
- Identifikimi dhe lehtësimi i procedurave nga specialistë të Qendrave Komunitare "Për Familjen" për të përfituar nga reduktimi/ shërbimi pa pagesë në çerdhe për fëmijët e familjeve në nevojë. - Aplikimi pranë Z1N-së - Realizimi i vlerësimit social-ekonomik të rastit nga specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale. - Miratimi nga Kryetari i Bashkisë. - Referimi për regjistrim pa tarifë pranë çerdes/kopshtit përkatës.							
b) Rezultatet që prisni							
- Rritja e gjithë përfshirjes dhe krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë individët dhe familjet në nevojë. - Rritja e përfshirjes dhe integritetit të fëmijëve në nevojë në kopshte. - Rritja e numrit të fëmijëve që frekuentojnë kopshtet.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Fëmijët që frekuentojnë kopshtet në Bashkinë e Shkodrës Familjet e fëmijëve që frekuentojnë kopshtet Komuniteti.				Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Mbështetje e fëmijëve në nevojë, përjashtim nga tarifa e pagesës.	1,910				1,910	
Shuma			1,910			1,910	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Mbështetje e fëmijëve në nevojë, përjashtim nga tarifa e pagesës.	1,910				1,910	
Shuma			1,910			1,910	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Mbështetje e fëmijëve në nevojë, përjashtim nga tarifa e pagesës.	1,910				1,910	
Shuma			1,910			1,910	
f) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
2026, 2027, 2028			Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale Drejtoria e Arsimit				
			Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.26		P.AI141.Q1.O2.A1. Mbështetja për punonjësit e Qendrës Kulturore të Fëmijëve Kujtim Alija		AI141. Arsimi				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit :								
i.Situata								
Bashkia e Shkodrës, në kuadër të mbështetjes dhe zhvillimit të arsimit, siguron mirëfunksionimin e një numri të madh institucionesh arsimore mbështetur në ligjinNr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Që në vitin 2015 me shkresë Bashkisë Shkodër i është transferuar krahsh shërbimeve të tjera dhe institucioni i Q.K.F.dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve për pagat dhe sigurimet. Për vitin 2025 Planifikimi i pagave është mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.113 Datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 425 Datë 26.06.2024 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe punonjësve të tjerë jo mësimorë në arsimin parauniversitar. Pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike në V.K.B. nr 12 datë 20.07.2023,V.K.M nr 328 datë 21.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të punonjësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore								
ii. Synimi i projektit								
Shërbime mbështetëse të higjienës në këtë institucion								
iii. Aktivitetet kryesore të projektit								
• Përshkrimi i detyrave të punës dhe sistemit të raportimit • Lidhja e kontratave të punës • Bashkërendimi me drejtuesin e Q.K.F. për shërbim më të mirë mbështetës. • Raportim, monitorim i shërbimit. • Kryerja e pagesave sipas listprezencës dhe punës së kryer të konfirmuar edhe nga drejtuesi i Q.K.F.								
b) Rezultatet që prisni								
• 5 punonjës që mbështesin të gjitha aktivitetet të qendrës kulturore të fëmijëve Kujtim Alija.								
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt				
Stafi mbështetës dhe ai drejtues				Bashkia e Shkodrës				
e) Shpenzimet e llogaritura								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Mbështetja për punonjësit e Qendrës Kulturore e Fëmijëve Kujtim Alija		7,213	6,223	990			
	Shuma		7,213	6,223	990			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Mbështetja për punonjësit e Qendrës Kulturore e Fëmijëve Kujtim Alija		7,213	6,223	990			
	Shuma		7,213	6,223	990			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Mbështetja për punonjësit e Qendrës Kulturore e Fëmijëve Kujtim Alija		7,213	6,223	990			
	Shuma		7,213	6,223	990			
f) Periudha e zbatimit			g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Bashkia Shkodër					
2026,2027,2028			Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.27	P.AI141.Q1.O2.A2. "Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë"	AI141. Arsimi
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i.Situata		
Konkursi i zërave "Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë" është tashmë një traditë në qytetin e Shkodrës. Kjo iniciativë lindi rreth 30 vjet më parë, në prill të vitit 1996 si iniciativë e Qendrës Kulturore të Fëmijëve "Kujtim Alija", Shkodër dhe në veçanti e "Mjeshtrit të Madh" Kujtim Alija, gjithashtu edhe si shprehje e nevojës së fëmijëve të Shkodrës për të shpalosur talentin e tyre në fushën e interpretimit,por edhe si një mundësi zëvendësimi e mungesës së Festivalit Lokal të Shkodrës. Kjo veprimtari që në nisje angazhoi një numër shumë të madh fëmijësh,mësuesish, si dhe specialistë të vokalit të qytetit e më gjerë. Kjo veprimtari rezultoi e suksesshme, pasi formati i saj, në shkallë kombëtare, u bë burim i disa veprimtarive të mëdha televizive. Për këtë arsye nuk është e rastësishme që fëmijët shkodranë në këto aktivitete u bënë fitues absolutë. Sikurse: R.Gjylbegu, R.Smaja,D.Garuci, G.Dume,T.Paçrami,R.Bashi, S.Vjerdha,J.Simoni, A.Ara etj. Kjo veprimtari, përveç këngëtarëve të muzikës zbavitëse dhe qytetare ka evidentuar dhe furnizuar me këngëtarë lirikë shkollën e mesme artistike "P.Jakova" (K.Rahimi, A.Lika,R.Rasha, B.Cina,I.Ademi etj) Bilbilat e vegjël, përveç talenteve ka shërbyer për promovimin e muzikës shqiptare për fëmijë duke u mundësuar mësimin e këtyre këngëve fëmijëve të Shkodrës, për një periudhë mjaft të gjatësi aktivitet që shtrihet nga dhjetori deri në prill. Konkursi "Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë" i shton çdo vit dhjetëra zëra të rinj skenave lokale e kombëtare, si rrjedhojë ka nevojë për pasion, përkushtim, investim të përditshëm deri në detajet e vogla. Bilbilat e vegjël, përveç zbulimit dhe mbështetjes së talenteve të reja, shërben për promovimin e muzikës shqiptare për fëmijë duke u mundësuar mësimin e këtyre këngëve fëmijëve të Shkodrës, për një periudhë mjaft të gjatë, si aktivitet që shtrihet në pesë faza, nga dhjetori –prill. Në edicionin e 30-të, u bënë pjesë një numër prej rreth 1500 fëmijësh nga shkollat publike dhe jopublike që përfshin Bashkia Shkodër. Risi e vitit të kaluar ishte zhvillimi i disa fazave të këtij aktiviteti në teatrin "Migjeni", duke bërë të mundur edhe përfshirjen e një numri të madh spektatorësh. Për vitin 2026 konkursi "Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë"(Edicioni 30-të), është menduar të zhvillohet në pesë faza si dhe në natën finale të këtij konkursi të ketë një numër të konsiderueshëm artistësh të ftuar,për të treguar se pikërisht nga ky konkurs i kanë fillimet e tyre artistët më të mirë shkodranë. Faza I – Përzgjedhja fillestare Zhvillohet në të gjitha shkollat e Bashkisë Shkodër, nën drejtimin e specialistëve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve dhe të fushës së artit për të mundësuar pjesëmarrjen e çdo fëmije me prirje muzikore. Faza II – Audicionet në Qendrën Kulturore të Fëmijëve Nxënësit konkurrojnë sipas një kalendarit të përcaktuar, nën mbikëqyrjen e stafit artistik. Faza III – Përgatitja muzikore Zhvillohet në ambientet e QKF-së; materiali muzikor përshtatet nga organizatorët sipas moshës dhe karakteristikave vokale të çdo pjesëmarrësi. Faza IV – Gjysmëfinalët Organizohen për disa ditë në Teatrin "Migjeni", me përfshirjen e jurisë profesionale dhe të publikut. Faza V – Finalja e madhe Në finale konkurrojnë më të mirët e përzgjedhur, të cilët shpallen fitues në disa kategori: Kategoria I – Klasat I–III: Çmimet I, II, III dhe një çmim inkurajues Kategoria II – Klasat IV–VI: Çmimet I, II, III dhe një çmim inkurajues Kategoria III – Klasat VII–IX: Çmimet I, II, III dhe një çmim inkurajues Në finalen e dytë garojnë: Formacionet korale (çmimet I, II, III dhe një çmim inkurajues) Solistët e këngës qytetare shkodrane (çmimet I, II, III dhe një çmim inkurajues) Ky konkurs, përveç evidentimit të talenteve të reja, ndërton ura bashkëpunimi mes brezave të muzikantëve shkodranë, forcon identitetin kulturor të qytetit dhe mbetet një ngjarje e rëndësishme në kalendarin e muzikës për fëmijë në Shqipëri.		
ii.Synimi i projektit		
- Dhënia e mundësive për evidentimin e talenteve në fushën e artit. - Mbështetja e talenteve për mundësi sa më të mira drejt suksesit në rrugën e artit. - Rritja e cilësisë dhe e jetës kulturorenë qytetare Shkodrës nëpërmjet inkurajimit dhe mbështetjes së brezit të ri. - Identifikimi i talenteve të reja në fushën e interpretimit të këngës nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve kulturore artistike.		
iii.Aktivitetet kryesore të projektit		
- Krijimi i grupit të punës, - Ndërtimi i platformës dhe kalendarit të konkurrimit. - Vendosja e kontakteve me shkollat. - Përzgjedhja e talenteve nga specialistët e QKF-së. - Mbështetja e mësuesve të muzikës me materiale. - Krijimi i jurive të seleksionimit dhe vlerësimit - Bashkëpunimi me krijues dhe aranzhues - Bashkëpunimim e Televizionet.		
b)Rezultatet që prisni		

• Evidentimi dhe përgatitja e talenteve të reja në fushën e këngës. • Kthimi i kësaj veprimtarie në një proces të gjatë të mësimit të këngës së zgjedhur shqiptare për fëmijë si dhe këngës qytetare dhe zbavitëse shqiptare. • Zbulimi dhe përgatitja e talenteve direkt në shkolla deri tek skajet më të largëtatë Bashkisë Shkodër. • Gjithë përfshirja dhe socializimi i fëmijëve për të gjitha grupmoshat. • Vazhdimi i traditës dhe suksesit të një pune rreth 30 vjeçare.						
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontribute te mundshme në projekt		
Stafi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija”, ZVAP Shkodër, Drejtoritë e IA, Nxënësit me prirje në muzikë të shkollave 9-vjeçare që përfshin Bashkia Shkodër. Specialistë të zgjedhur të vokalit, kompozitorë, mësuesit e muzikës, aranzhues, skenaristë, regjizorë, skenografë, koreografë, aktorë të teatrit “Migjeni”				Bashkia Shkodër, QKF “Kujtim Alija” Shkodër.		
e)Shpenzimetellogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Honorare, Skenografi,(maket + realizim) 1 person x 30 lekë (faza II,III,IV)	30			30	
A.2	Honorare, Skenografi LED Ëall 1 person x 50 lekë (faza finale)	50			50	
A.3	Honorare, Fonist 1 person x 30 lekë	30			30	
A.4	Honorare, Ndriçim 1 person x 20 lekë	20			20	
A.5	Honorare, Orkestracion 2 kolazhe x 50 lekë	100			100	
A.6	Honorar, Skenari (faza IV, V) 1 person x 40 lekë	40			40	
A.7	Honorar, Moderimi 1 person/grup x 10 lekë	10			10	
A.8	Honorar,Juri,faza II,III,IV (12 ditë) 5 persona x 1.5 lekë dita / për person	90			90	
A.9	Honorar, Juri, faza finale 5 persona x 10 lekë për person	50			50	
A.10	Honorar, Mësues muzike	30			30	
A.11	Cmime per fituesit(mesuesit e koreve) 15+10+50	30			30	
A.12	Honorar, Regjia 1 person *20 leke	20			20	
A.13	Honorar, koncertmaester 1 person* 20 leke	20			20	
A.14	Honorar, Mjeshter vokali 2person x 25 lekë	50			50	
A.15	Honorar, koreograf 1 person x 25 lekë	25			25	
A.16	Honorar, Fotograf 1 person* 30 leke	30			30	
A.17	Promocion i aktivitetit (ftesa,poster,baner,kancelari)	30			30	
A.18	Stimuj (dhurata për fituesit)	70			70	
		725			725	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
	Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë	725			725	
	Shuma	725			725	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
	Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë	725			725	
	Shuma	725			725	
f)Periodha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			
2026,2027,2028			Stafi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve“ Kujtim Alija” Drejtoria e Përgjithshme Kulturës dhe Drejtoria e Kulturës Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr.28	P.AI141.Q1.O2.A3. Festivali i 64-të mbarëkombëtar për fëmijë	AI141. Arsimi
a)Përshkrimi i shkur të ri projektit:		
i.Situata		
Shkodra,djepi i këngës qytetare, më 10- 11 maj 1963 me angazhimin e forcave krijuese të qytetit, organizoi festivalin e parë të këngës për fëmijë. Ditët e festivalit u bënë ditët e "gjallesës" të një "sedre tradicionale kulture" të qytetit, kurse jehona e tij i shtyu organizatorët të vazhdonin rrugën e nisur. Festivali u bë kombëtar në vitin 1966. Me të u plotësua një boshllëk i ndjeshëm në edukimin muzikor të fëmijëve.Por krahas muzikës, festivali u dha fëmijëve mundësinë të qëndronin së bashku. Shkodra u bë edhe një nga vendet më të dashura për fëmijët nga e gjithë Shqipëria. Emocionet e konkurrimit i takonin skenës. Jashtë saj lindën njohje dhe miqësi të reja. Vitet "90 shënuan risi të tjera. Edicioni i 31-të, në vitin 1992, përfshiu krijuesit dhe interpretuesit nga të gjitha trojet shqiptare, duke e kthyer festivalin deri në këtë kohë kombëtar në një Festival Mbarëshqiptar të Këngës për Fëmijë. Ai vijoi të jetë ngjarja artistike më e rëndësishme për fëmijë. Kënga iu përgjigj ndryshimeve, por ruajti veçantinë, fizionominë kombëtare dhe vlerat artistike. Festivalet patën ngritje cilësore edhe në organizim:u rrit hapësira skenike me dekore të mëdha, u realizuan librete të zgjedhura e prezantime origjinale.Arti regjisorial synoi daljen në pah të lirshmërisë në interpretim dhe talentit të ekzekutuesve të vegjël. Skena e këtij festivali në vite u bë rrugë për një shumicë këngëtarësh që u bënë të shquar dhe fushë veprimtarie për kompo-zitorë, skenaristë, autorë tekstesh, regjisorë, koreografë, skenografë, dirigjentë, instrumentues, orkestrues, mjeshttra vokali "Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë, edicioni i 64-të" do të zhvillohet më 30 dhe 31 maj, ndërsa finalja më 1 qershor 2026, në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve. Kjo datë simbolike e mban gjallë shpirtin e festës së këngës shqiptare, duke e ndjekur nga mijëra artdashës në Shkodër, në trevat shqiptare dhe në mbarë botën, falë transmetimit satelitor dhe platformave online. Edicioni i sivjetshëm do të promovojë 20 këngë të reja, të përzgjedhura si krijimet më të mira të kompozitorëve, poetëve dhe aranzhuesve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Diaspora. Në skenë do të ngjiten këngëtarë të moshës 5–14 vjeç, të ndarë në dy kategori: Grupmosha 5–8 vjeç Grupmosha 9–14 vjeç Risi e këtij festivali ishte marrëveshja e arritur midis Bashkisë Shkodër dhe Radio Televizionit Shqiptar, sipas së cilës kënga fituese e kategorisë 9 – 14 vjeç do të përfaqësojë Shqipërinë në "Junior Eurovision Song Contest". Kjo arritje e veçantë e ngre Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë në një nivel të ri ndërkombëtar, duke i dhënë fëmijëve shqiptarë mundësinë të prezantojnë talentin dhe kulturën tonë muzikore në skenën evropiane Ky festival, i vetmi i këtij lloji në hapësirën shqipfolëse, ruan dhe çon përpara traditën e gjatë dhe të suksesshme të këtij zhanri, duke nxitur talentin e fëmijëve përmes përmirësimit të cilësisë së interpretimit dhe këndimit live.		
ii.Synimi i projektit		
- Identifikimi i talenteve të reja në fushën e interpretimit të këngës nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve kulturore artistike. - Dhënia e mundësive për evidentimin e talenteve në fushën e artit. - Mbështetja e talenteve për mundësi sa më të mira drejt suksesit në rrugën e artit. - Rritja e cilësisë dhe e jetës kulturore në qytetin e Shkodrës nëpërmjet inkurajimit dhe mbështetjes së brezit të ri.		
iii.Aktivitetet kryesore të projektit		
- Ndërtimi i planit të punës, - Krijimi i grupit të punës, - Vendosja e kontakteve me krijuesit të të gjitha trevave, - Krijimi i komisionit të seleksionimit dhe vlerësimit, - Seleksionimi dhe organizimi i grupeve të mëdha vokale dhe baletit, - Bashkëpunimim e institucione të tjera. - Furnizimi dhe blerja e shërbimeve dhe të logjistikës për realizimin e festivalit.Organizimi i festivalit. - Monitorimi dhe raportimi. - Realizimi i pagesave për shërbimet dhe personelin,e artiste të angazhuar.		
b)Rezultatet që prisni		
- Ruajtja e suksesit dhe traditës së gjatë 64 vjeçare - Pas urimiifondit të këngës shqiptare për fëmijë. - Evidentimi dhe përgatitja e talenteve të reja në fushën e këngës. - Kthimi i veprimtarisë në festë të këngës përgjatë gjithë ditëve të provave dhe koncerteve. - Rritja e atraksionit turistik kulturor të Shkodrës nëpërmjet realizimit të Festivalit në Pedonalen kryesore të qytetit. - Pjesëmarrje e gjerë e fëmijëve së bashku me prindërit në këtë aktivitet dhe stimuli i lidhjes së tyre.		
c)Aktorët e mundshëm		d)Kontributet e mundshme në projekt
Fëmijët, Q.K.e Fëmijëve, Shkollat 9 vjeçare, Krijues bashkëpunëtorë, muzikantë dhe këngëtarët e vegjël nga të gjithë trevat shqipfolëse, mediat e ndryshme e televizioni publik shqiptar.		Bashkia Shkodër, Q.K.e Fëmijëve,Teatri Migjeni, Qendra Kultures Pjeter Gaci
e)Shpenzime të llogaritura		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Honorare, Autori i muzikes persona x 35 lekë	20	700			700		
A.2	Honorare, Autori i tekstit 20 persona x 20 lekë		400			400		
A.3	Honorare,Redaktor muzikor 1 person x 40 lekë		40			40		
A.4	Cmime fituese (6 kenge) 2*50+2*30+2*20		200			200		
A.5	Honorare, Skenarist 1 person x 100 lekë		100			100		
A.6	Honorar, Redaktor letrar 1 person *40 leke		40			40		
A.7	Honorar, Moderator 2 persona/ grup*100 leke		100			100		
A.8	Honorar,, Prodhues trofe artizanale 1 person *30 leke		30			30		
A.9	Honorar,Regjisor 1 persona x 150 lekë për person		150			150		
A.10	Honorar,Skenograf 1 person x 150 lekë për person		150			150		
A.11	Skenia, Fonia, Ndricim, Projektim skenik		1100			1100		
A.12	Veshje për fëmijët e Festivalit		500			500		
A.13	Shpenzime akomodimi		1500			1500		
A.14	Shpenzime ushqimi		800			800		
A.15	Shpenzime transporti		30			30		
TOTALI			5,840			5,840		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Festivali 65-tëKombëtar për fëmijë		5,840			5,840		
Total			5,840			5,840		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Festivali 66-të Kombëtar për fëmijë		5,840			5,840		
Total			5,840			5,840		
f)Periudha e zbatimit			g)Përgatiti dhe ndjek realizimi ne projektit:					
2026,2027,2028			Stafi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija” Drejtoria e Përgjithshme Kultures dhe Drejtoria e Kultures Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.29	P.AI141.Q1.O2.A4. Veprimtari masive (sportive, artistike e shkencore) të Qendrës Kulturore të Fëmijëve	AI141. Arsimi
a)Përshkrim i i shkurtër i projektit:		
i.Situata		
Qendra Kulturore e Fëmijëve “Kujtim Alija”organizon gjatë vitit, sipas kalendarëve të përcaktuari disa veprimtari masive sportive,artistike dhe shkencore, mbi bazën e platformave që ndërton dhe ua shpërndan shkollave 9- vjeçare. Këto veprimtari gjallërojnë dukshëm sheshet, fushat sportive,palestrat dhe sallat që ka qyteti ynë.Nga më kryesoret veçojmë: Në gjashtëmujorin e parë Janar - Qershor 1. Kampionati i shahut në mes shkollave 9- vjeçare publike dhe jopublike që përfshin Bashkia Shkodër. Marrin pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem (AF + AMU) Një vajzë dhe një djalë nga kl 1-5 (AF) dhe një vajzë dhe një djalë nga kl 6-9 (AMU) 2. Kampionati i ping pongut në mes shkollave 9- vjeçare publike dhe jopublike që përfshin Bashkia Shkodër. Marrin pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem (AF + AMU) Një vajzë dhe një djalë nga kl 1-5 (AF) dhe një vajzë dhe një djalë nga kl 6-9 (AMU) 3. Kampionatet pranverore në Basketboll, Volejboll dhe Minifutboll, vajza dhe djem, në mes shkollave 9- vjeçare Publike dhe jopublike që përfshin Bashkia Shkodër. Këto veprimtari realizohet në tri faza mbi shortin që hidhet në fillim dhe veprohet me sisteme liminimi. Zhvillohet në disa terrene dhe palestra të qytetit tonë për arsye të përmasave që ka dhe zgjat rreth një muaj e gjysmë. Në fund shpalle ne ekipet fituese për secilën disiplinë. 4. Zbavitimi me gjuhët e huaja. Marrin pjesë anëtarë të kurseve të gjuhëve të huaja të QKF “Kujtim Alija”(150 fëmijë) si dhe nxënës të dalluar në këtë fushë nga shkollat 9- vjeçare. Veprimtaria organizohet në sallën e QKF-së dhe trajtohet si variete ku nxënësit shpalosin arritjet e tyre përmes dramatizimeve,këngëve,recitimeve dhe humorit në gjuhë të huaja. Në gjashtë mujorin e dytë Shtator - Dhjetor 5. Garë me biçikleta me fëmijët e kopshteve publike dhe jopublike të Bashkisë Shkodër. Veprimtaria sportive “Gara me biçikleta” gjatë viteve të fundit zhvillohet në muajin tetor në ambientet e stadiumit “Loro Boriçi”.Si një aktivitet i traditës rreth 30 vjeçare rezulton shumë i dashur jo vetëm nga fëmijët, por edhe nga prindërit,gjyshërit por edhe qytetarët shkodranë.Kjo ditë kthehet në një festë për këtë grupmoshë fëmijësh. Marrin pjesë nga çdo kopsht 2 vajza dhe 2 djem. Në bazë të rezultateve shpallen fitues 3 vajza (vendi I,II,II) dhe 3 djem (vendi I,II,III) Risi në veprimtarinë sportive “ Gara me biçikleta 2024 ”, ishte pajisja e secilit fëmijë me aksesoret e sigurisë. (kokore,gjunjëza dhe mbrojtëse për bërrylat) 6. Kampionati i vrapimit në natyrë “Gara vrapimi”,mes shkolla 9- vjeçare ,publike dhe jopublike që përfshin Bashkia Shkodër. Kampionati i vrapimit në natyrë “Gara vrapimi”,mes shkolla 9- vjeçare ,publike dhe jopublike që përfshin Bashkia Shkodër,organizohet gjatë muajit nëntor.Në këtë veprimtari sportive marrin pjesë nga çdo shkollë: 2 vajzadhe 2 djem(AF + AMU) Një vajzë dhe një djalë nga kl 1-5 (AF) dhe një vajzë dhe një djalë nga kl 6-9 (AMU) “Gara vrapimi 2024”shënoi një numër të madh të shkollave dhe nxënësve pjesëmarrës. 7. Konkursi i fjalës artistike në mes shkolla 9- vjeçare ,publike dhe jopublike që përfshin Bashkia Shkodër. Konkursi zhvillohet në tri faza. Në fazën e parë konkursi zhvillohet brenda shkollës nga ku përcaktohen më të mirët që përfaqësojnë shkollën në fazën e dytë, në QKF Në këtë fazë marrin pjesë të gjitha shkollat 9-vjeçare publike dhe jopublike që mbulon Bashkia Shkodër. Në fazën e dytë shkollat konkurrojnë sipas kalendarit të përcaktuar në platformë. Çdo shkollë do te paraqesë 7 (shtatë) konkurrentë : Tre nxënës nga AF, tre nga AMU dhe një (individ ose grup) në fushën e humorit. Në bazë të pikëve të fituara, recituesit më të mirë të çdo shkolle shkojnë në fazën finale dhe konkurrojnë për të shpallur 9 fituesit: Vendi I , II ,III dhe çmimi inkurajues për Arsimin Fillor.(AF , Kl 1-5) Vendi I , II ,III dhe çmimi inkurajues për Arsimin e Mesëm të Ulët. (AMU, Kl 6-9) Si dhe çmimi i humorit. (individ ose grup) Në këto aktivitete përveç fëmijëve të talentuar nëfushat respektive,angazhohen edhe mësuesit e edukimit fizik,mësues të gjuhës dhe letërsisë,trajnerë, gjyqtarë, regjisorë,aktorë, moderatorë dhe shkrimtare nga më të dalluarit që ka qyteti ynë. Të gjitha këto veprimtari kanë fituesit e tyre të cilët stimulohen. Këto veprimtari ndiqen me shumë interes nga specialist të fushave përkatëse që seleksionojnë fëmijët më të talentuar ,për të afruar dh mbështetur ato në jetën kulturore dhe sportive të qytetit.		
ii.Synimi i projektit		
• Promovimin e veprimtarisë së rregullt fizike dhe edukimin e një stili jetese aktiv. • Të rritet cilësia e jetës kulturore në qytetin e Shkodrës nëpërmjet inkurajimit dhe mbështetjes së brezit të ri. • Identifikimi i talenteve të reja në fushën e interpretimit nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve kulturore artistike. • Gjallërimi i jetës sportive dhe kulturore të fëmijëve gjatë gjithë vitit kalendarik • Zhvillimi dhe ruajtja në nivele optimale e cilësive fizike dhe psikomotorre të fëmijëve • Zbulimin dhe përgatitjen e talenteve të reja në fushën e sportit • Zbulimin dhe përgatitjen e fëmijëve të talentuar në fushën e interpretimit skenik dhe humorit		
iii.Aktivitetet kryesore të projektit		

• Përcaktimi i platformave respektive për secilën veprimtari • Ndërtimin e kalendarëve respektive • Hedhja e shortit • Përcaktimi i gjyqtarëve dhe jurive • Përcaktimi i grupeve realizuese • Ndërtimi dhe regjistrimi i ekipeve pjesëmarrëse • Vendosja e kontakteve me IA,dhe mësuesit përkatës. • Monitorimi i të gjitha fazave të përcaktuara në platformat përkatëse.							
b)Rezultatet që prisi							
• Evidentimi dhe përgatitja e talenteve të reja në fushën sportit dhe artit. • Aktivizimi në kohën e lirë të brezit të fëmijëve me veprimtari sa të bukura dhe interesante aq edhe të shëndetshme . • Gjallërimi gjatë gjithë vitit i jetës kulturore e sportive në qytetin e Shkodrës. • Të ushtruarit e aktivitetit spoertiv në mënyrë sistematike, si dhe edukimin e disiplinës, vullnetit, vetëvlerësimit dhe konkurrencës së ndershme. • Inkurajimi tek fëmijët i pavarësisë krijuese lëvizore dhe i marrëdhënieve bashkëpunuese dhe bashkëvepruese në • procesin e të ushtruarit me të tjerë. • Ruajtja dhe avancimi i traditës së gjatë mbi 60 vjeçare të organizimit të kampionateve sportive dhe garës së interpretimit nga ana e QKF-së							
c)Aktorët e mundshëm			d)Kontributet e mundshme në projekt				
Stafi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve“Kujtim Alija”, ZVAP shkodër, Drejtoritë e IA, Fëmijët e kopshteve Nxënësit me prirje në sporte të shkollave 9-vjeçare që përfshin Bashkia Shkodër. Specialistë të zgjedhur të sportit,gjyqtarë,			Bashkia Shkodër, QKF“Kujtim Alija” Shkodër.				
e)Shpenzime te llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime
A.1	Honorare, Gjyqtarë (Vep.sportive) 1.2lekë për person në ditë	100			100		
A.2	Honorare, Anëtarë jurie (Fjala artistike) 5 persona x 1.2 lekë për person x 8 ditë	48			48		
A.3	Honorare ,Skenografi (Fjala artistike,Faza II) 1 person x 30lekë	30			30		
A.4	Honorare ,Skenografi, (Fjala artistike-Finale) 1 person x 50 lekë	50			50		
A.5	Honorare, Fonist 1 person x 10 lekë	10			10		
A.6	Honorare, Ndriçim 1 person x 10lekë	10			10		
A.7	Honorare, Skenari (Fjala artistike) 1 person x 20 lekë	20			20		
A.8	Honorare, Moderimi (Fjala artistike) 1 person x 10 lekë	10			10		
A.9	Honorare, Orkestracion 2 x 20lekë	40			40		
A.10	Honorar, Koreograf 1 person x 20lekë	20			20		
A.11	Honorare,Skenografi (Zb. me gjuhët e huaja) 1 person x 20lekë	20			20		
A.12	Honorar, Fotograf (albumi i aktiviteteve) 1 person x 30lekë	30			30		
A.13	Bazë materiale për zhvillimin e veprimtarive sportive.	45			45		
A.14	Libra jashtëshkollor përfituesit e Fjalës artistike	35			35		
A.15	Promocioni7 aktiviteteve (poster,baner,numra sportistësh,badge,etj)	50			50		
A.16	Stimuj për 7 aktivitete Kupa,medalje,diploma,dhurata për fituesit	90			90		
	Shuma	608			608		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime

A.1	Veprimtari masive (sportive,artistike e shkencore) të Qendrës Kulturore të Fëmijëve	608			608		
	Shuma	608			608		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Veprimtari masive (sportive,artistike e shkencore) të Qendrës Kulturore të Fëmijëve	608			608		
	Shuma	608			608		
f)Periudha e zbatimit 2026,2027,2028		g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija” Drejtoria e Pergjithshme Kulturës dhe Sporteve- Drejtoria e Sporteve Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.30	P.AI141.Q1.O2.A5. Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore	AI141. Arsimi
a)Përshkrim i ishkuartër i projektit:		
i.Situata		
QKF “Kujtim Alija”,e mbështetur nga Bashkia Shkodër vazhdon traditën 75 vjeçare të punës me disa nga kurset jashtëshkollore më të kërkuara, me rezultate dhe të dashura nga fëmijët. Kjo veprimtari funksionon që me krijimin e këtij institucioni dhe ka përfshirë në çdo vit numër të madh fëmijësh. Pranë QKF “Kujtim Alija”, janë afruar fëmijë të talentuar në fushat respektive të cilët argëtohen, aftësohen dhe stërviten nga grup mësuesish dhe specialistësh të përkushtuar në fushën e artit, sportit edhe shkencës. Nga kjo veprimtari e suksesshme në vite kanë dalë figura të spikatura të artit e sportit që kanë shkëlqyer në skenat dhe fushat sportive kombëtare e më gjërë. Viti mësimor 2025 shënoi një rritje të konsiderueshme të numrit të fëmijëve që u antarësuan në QKF “Kujtim Alija”, në kurset jashtëshkollore që ofron kjo qendër.(rreth 1000 fëmijë frekuentuan rregullisht kurset) Nisur nga kërkesat dhe interesimi i lartë për regjistrime në kurse të veçanta, në këto kushte është menduar,diskutuar e planifikuar për t’u përshtatur në kushte te reja në të cilat ndodhemi duke propozuar mundësinë e zgjerimit të veprimtarive. Viti 2026 shënon një tjetër sfidë për QKF “Kujtim Alija”,me synimin për të plotësuar kushtet që të tre sektorët të plotësohen me numrin e kurseve që kërkon kurrikula e këtij institucioni,pra është e domosdoshme të shtojmë edhe pesë kurse të tjera të edukimit duke plotësuar strukturën e funksionit të QKF-së. Fushat e edukimit ku fëmijët janë të aktivizuar në kurse janë:		
1. Kërcim 2. Kërcim 3. Trombë 4. Fizarmonikë 5. Kitarë 6. Kitarë 7. Këndim 8. Pikturë 9. Pikturë 10. Piano 11. Piano 12. Estradë 13. Basketboll (vajza) 14. Basketboll (djem) 15. Volejboll 16. Futboll (AF) 17. Futboll (AMU) 18. Shah 19. Atletikë 20. Anglisht 21. Anglisht 22. Anglisht 23. Frengjisht 24. Gjermanisht 25. Italisht 26. Skenografi 27. Arte & zeje 28. Aerobi 29. Perkusion 30. Violinë		
• Qasja e fëmijëve drejt aktiviteteve kulturore ,sportive dhe shkencore. • Gjallërimi i jetës kulturore, artistike, sportive e shkencore, të brezit të ri gjatë gjithë vitit. • Zbulimin dhe përgatitjen e talenteve të reja në fushën e artit, sportit e shkencës • Evidentimin dhe paraqitjen në publik të artistëve e sportistëve të talentuar që ka Shkodra për këto grupmosha.		
iii.Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerri për të prodhuar rezultate)		
• Përcaktimi i strukturës. • Ndërtimin i planeve të punës së kurseve. • Përcaktimi dhe sigurimi i bazës materiale që duhet për zhvillimin e këtyre kurseve. • Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimi me ZVAP,dhe IA. • Seanca prezantuese për kurset që ofrohen në QKF “Kujtim Alija”Shkodër • Seleksionimi,regjistrimi dhe krijimi i ekupeve dhe grupeve. • Ndërtimi i orarit • Kontrolli i vazhdueshëm i mbarëvajtjes së kurseve. • Dorëzimi i dokumentacionit përkatës për çdo kurs.		
b)Rezultatet që prisni		
• Zbulimi dhe përgatitja e talenteve të reja në fushën e artit, sportit dhe shkencës • Kalimi i kohës së lirë të fëmijëve me aktivitete konkrete. • Gjallërimi gjatë gjithë vitit i jetës kulturore, sportive e shkencore në qytetin e Shkodrës. • Inkurajimi tek fëmijët i pavarësisë krijuese lëvizore dhe i marrëdhënieve bashkëpunuese dhe bashkëvepruese në procesin e të ushtruarit me të tjerë. • Ruajtja dhe avancimi i traditës së gjatë mbi 60 - vjeçare të funksionimit të rretheve jashtëshkollore nga ana e QKF-së. • Socializimi i fëmijëve me njëri-tjetrin dhe shkëmbimi i eksperiencave jetësore.		
c)Aktorët e mundshëm		d)Kontribute te mundshme në projekt
Stafi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve“Kujtim Alija”, ZVAP Shkodër,Drejtoritë e IA Specialistë të artit,sporti te shkencës		Bashkia Shkoder, QKF“Kujtim Alija”Shkodër
e)Shpenzimetellogaritura		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:
		PagaSigurimeOperativeTransferimeKapitale

A.1	Honorare:Ora e mësimit 300 lekë/orë	2,079			2,079		
	Shuma	2,079			2,079		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Honorare:Ora e mësimit 300 lekë/orë	2,079			2,079		
	Shuma	2,079			2,079		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Honorare:Ora e mësimit 300 lekë/orë	2,079			2,079		
	Shuma	2,079			2,079		
f) Periudha e zbatimit 2026,2027,2028		g)Përgatit dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve "Kujtim Alija" Drejtoria e Arsimit, Bashkia Shkodër Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.31	P.A141.Q1.O2.A6. Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri për nxënësit e shkollave 9-vjeçare.	A141. Arsimi				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
Mbrëmja tradicionale e Vitit të Ri ka një traditë më shumë se 60-vjeçare, realizuar pa ndërprerje çdo vit nga QKF "Kujtim Alija" (ish Shtëpia e Pionierit) në fund të muajit dhjetor, me mbështetjen e Bashkisë Shkodër. Ajo stimulon nxënësit e dalluar të shkollave 9-vjeçare që përfshin Bashkia Shkodër,si dhe nxënësit e talentuar që kontribuojnë në aktivitetet e qytetit., që zgjidhen nga Institucionet Arsimore dhe stafi i QKF-së. Kjo mbrëmje shërben si premierë e talenteve të humorit,këngës,baletit dhe aerobisë së QKF dhe si stimulim i nxënësve më të mirë të qytetit;(stimulohen rreth 60 nxënës të dalluar Arsimit Fillor të shkollave 9-vjeçare dhe rreth 125 artistë dhe sportistë të vegjël).Duke i mbështetur këto fëmijë,ne investojmë në një të ardhme më të mirë. Gjithashtu kjo mbrëmje stimulon bashkëpunimin e artistëve të afirmuar,të cilët ftohen si mysafirë nderi.Kjo gjë rrit interesin dhe pëlqyeshmërinë dhe e bëjnë këtë aktivitet shumë argëtues. Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri konceptohet si një festë që përfshin një numër të madh fëmijësh dhe prindërish.						
ii.Synimi i projektit						
• Rritja e cilësisë dhe e jetës kulturore në qytetin e Shkodrës nëpërmjet inkurajimit dhe mbështetjes së brezit të ri. • Identifikimi i talenteve të reja në fushën e interpretimit të këngës nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve kulturore artistike. • Mbështetja dhe motivimi për të siguruar arritjen e potencialit të tyre. • Zgjerimi i bazës së kësaj veprimtarie me nxënës të talentuar dhe nga shkollat e periferisë që administron tashmë Bashkia Shkodër. • Gjallërimi i jetës kulturore e artistike të brezit të fëmijëve në kuadër të festave të fundvitit • Evidentimi i arritjeve të fëmijëve në mësim,në art dhe sport. • Bashkëpunimi me artistë e specialistë të fushave të ndryshme nën udhëheqjen e QKF-së. • Realizimi i një Premiere sa më argëtuese dhe cilësore për të gjithë fëmijët e Shkodrës,përmes transmetimit televiziv.						
iii.Aktivitetet kryesore të projektit						
• Përcaktimi I grupit realizues • Kontakti me ZVAP Shkodër. • Vendosja e kontakteve me shkollat për përcaktimin e fëmijëve të dalluar. • Përcaktimi i materialeve për realizimin e libretit • Përzgjedhja e materialeve muzikore dhe koreografike • Përcaktimi i aktorëve, solistëve,instrumentistëve, grupeve vokale dhe grupeve të baletit. • Promovimi i aktivitetit. Bashkëpunimi me mediat.						
b)Rezultatet që prisni						
• Evidentimi dhe paraqitja në publik e nxënësve të dalluar të shkollave 9 –vjeçare dhe e talentëve të reja në fusha të ndrysh- me të shkencës, artit dhe sportit. • Afishimi i arritjeve të këtyre talentëve në veprimtaritë lokale e kombëtare. • Ruajtja dhe përparimi i traditës mbi 60-vjeçare i këtij aktiviteti. • Trajtimi në skenar i temave të dashura por edhe i atyre që shqetësojnë brezin e fëmijëve të sotëm. • Fëmijëve t'u krijojmë kujtime të bukura që mbeten gjithmonë.						
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontribute te mundshme në projekt		
Q.K.e Fëmijëve,drejtoritë e Shkollave 9 vjeçare, Nxënës, artistë, sportistë të dalluar, shkrimtarë, aktorë, aranzhues, regjisor, koreograf, skenograf, Koncert maester etj.				Bashkia Shkodër, Q.K.e Fëmijëve,		
e)Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Lodra për fëmijë	250	Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.2	Honorare: Krijimtaria dhe realizimi Libreti + materiale humoristike 50lekë. Skenografi (materiale + realizim)60 lekë Regjia 30 lekë Balet (për person) 8 lekë Aktor i ftuar (për person) 12 lekë Orkestracion 35lekë	195			195	
	Shuma	445			445	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale

A.1	Lodra për fëmijë	250			250		
A.2	Honorare: Krijimtaria dhe realizimi Libreti + materiale humoristike 50lekë. Skenografi (materiale + realizim) 60 lekë Regjia 30 lekë Balet (për person) 8 lekë Aktor i ftuar (për person) 12 lekë Orkestracion 35 lekë	195			195		
	Shuma	445			445		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Lodra për fëmijë	250			250		
A.2	Honorare: Krijimtaria dhe realizimi Libreti + materiale humoristike 50lekë. Skenografi (material + realizim) 60 lekë Regjia 30 lekë Balet (për person) 8 lekë Aktor i ftuar (për person) 12 lekë Orkestracion 35 lekë	195			195		
	Shuma	445			445		
f) Periudha e zbatimit 2026,2027,2028			g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria arsimit Bashkia Shkodër Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 32		P.A141.Q1.O2.A7. Mbështetje shkolla "Prenk Jakova"		A141. Arsimi		
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
Shkolla Artistike Kombëtare "Prenkë Jakova" në Shkodër Më 18 janar 1961 u hap në Shkodër, Shkolla 8-vjeçare e Muzikës, një projekt i mundësuar nga përpjekjet e vazhdueshme të muzikantëve të njohur të qytetit, si Ndoc Shllaku dhe Gjon Kapidani, dhe me mbështetjen e kompozitorit Prenkë Jakova, i cili kërkonte që të ruhej dhe të vazhdonte tradita kulturore e qytetit. Në fillim, shkolla kishte 25 nxënës dhe 3 mësues, të cilët mësonin violinë dhe piano. Në vitin shkollor 1963-1964, hapet dhe klasa e violonçelit, ndërsa tre vjet më vonë, në vitin 1966, shtohet edhe klasa e klarinetës dhe flautit. Në vitin shkollor 1970-1971, Shkolla e Muzikës shndërrohet në Shkollën e Mesme të Muzikës (12-vjeçare), ku ofrohen degët: violinë, violë, violonçel, kontrabas, piano, kanto, dhe instrumenta fryme. Në vitin shkollor 1974-1975, pranë kësaj shkolle hapet dega e pikturës, dhe pesë vjet më vonë, në vitin 1980, hapet dega e skulpturës. Kjo i dha shkollës një formë të plotë si shkollë artistike, me dy drejtime kryesore: dega e muzikës dhe dega e arteve figurative, që funksionon edhe sot. Në vitin 1981, me rastin e 20-vjetorit të krijimit të shkollës, Shkolla Artistike e Shkodrës mori emrin "Prenkë Jakova". Deri tani, nga kjo shkollë kanë mbaruar plot 1830 nxënës, prej të cilëve mbi 600 kanë vazhduar studimet në Akademinë e Arteve në Tiranë, dhe pas viteve '90, shumë prej tyre kanë vazhduar studimet në akademitë muzikore të Evropës. Një vend të rëndësishëm në jetën e Shkollës Artistike Kombëtare "Prenkë Jakova" zënë edhe veprimtaritë artistike. Koncertet e para të dhëna nga nxënësit e shkollës datojnë që nga vitet 1962-1963. Pas hapjes së shkollës së mesme, janë formuar disa formacione artistike që funksionojnë edhe sot, si: orkestra simfonike, orkestra frymore, formacioni i tunxhit, formacioni koral, ansamble të vogla instrumentale. Këto formacione kanë pasur një veprimtari artistike të gjallë brenda qytetit, në qytetet kryesore të Shqipërisë dhe jashtë vendit, si në Itali, Mali i Zi, Greqi, Gjermani, Bullgari, etj. Një nga arritjet më të shënuara të veprimtarisë artistike të kësaj shkolle ka qenë vënia në skenë e aktit të parë të operës "Mrika" të kompozitorit Prenkë Jakova, nga nxënësit e shkollës, në vitin 1983. Në konkurset artistike muzikore kombëtare dhe ndërkombëtare, Shkolla Kombëtare Artistike "Prenkë Jakova" është vlerësuar tre herë me flamurin e aktivitetit dhe ka marrë çmime të para. Po ashtu, në fushën e arteve figurative, shkolla është vlerësuar me çmime të para në rang kombëtar, dhe për disa vite, nxënësit e këtij sektori janë shpallur fitues të çmimeve të para në konkurset ndërkombëtare, si në Portugali, Mali i Zi, Itali, Maqedoni, Austria, etj. Pedagogët e kësaj shkolle kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për zhvillimin dhe pasurimin e traditës muzikore të Shkodrës, si krijues, interpretues, dhe si anëtarë të korit dhe orkestrave simfonike dhe frymore të qytetit. Orkestra simfonike e shkollës, me instrumentistët, solistët dhe krijuesit e saj, pas viteve '90 ka marrë pjesë në shumë aktivitete ndërkombëtare, si në Itali, Zvicër, Austria, Mali i Zi, Gjermani, Greqi, etj., ku janë përfaqësuar me dinjitet artistik dhe kanë marrë vlerësime të larta. Shkolla Kombëtare Artistike "Prenkë Jakova", prej vitesh ka marrëdhënie të ngushta profesionale me shkolla të ngjashme në vend dhe në Evropë, si dhe me Akademinë e Arteve në Tiranë dhe akademi të tjera evropiane. Stafi pedagogjik i kësaj shkolle, gjatë viteve, ka kontribuar me sukses në hartimin dhe përmirësimin e programeve kombëtare, duke ofruar një arsimin artistik të nivelit të lartë.						
ii.Synimi i projektit						
• Të rritet cilësia e jetës kulturore në qytetin e Shkodrës në për mjetin kurajimit dhe mbështetjes së brezit të ri. • Identifikimi i talenteve të reja në luajtjen me instrument nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve kulturore artistike. • Gjallërimi i jetës kulturore e artistike të brezit të fëmijëve. • Evidentimi i arritjeve të fëmijëve në mësim në art dhe muzikë • Bashkëpunimi me artistë e specialistë të shkollës së edukimit për zhvillimin e edukimit të fëmijëve,përmes artit dhe muzikës. • Realizimi i aktiviteteve artistike në Shkollën"Prenk Jakova",nga mësuesit dhe nxënësit e shkollës..						
iii.Aktivitetet kryesore të projektit						
- Përcaktimi i grupit realizues - Përzgjedhja e materialeve muzikore; - Orkestrimi materialeve muzikore; - Përgatitje e nxënësve për shfaqjen artistike; - Organizimi i eventit artistik; - Monitorim dhe raportim i punës së realizuar me nxënësit dhe fëmijët.						
b)Rezultatet që prisni						
1.Evidentimi dhe paraqitja në publike nxënës vetëdalluar të shkollës "Prenk Jakova"dhe e talenteve të reja në këngë dhe muzikë. 2.Përfshirje e arritjeve të këtyre talenteve në veprimtaritë lokale e kombëtare. 3. Ruajtja dhe përparimi traditës së shkollës "Prenk Jakova"						
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt		
Shkolla e muzikës "Prenk Jakova"Nxënësit,mësuesit;				Bashkia Shkodër, Shkolla e muzikës "Prenk Jakova"		
e)Shpenzime të llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Regjia 1*30 leke /person	30			30	
A.2	Skenografia 1 x 40 lekë / person	40			40	

A.3	Inspektor skene 1x10 leke /person	10			10		
A.4	Udhëheqës artistik 1 x 20 lekë/person	20			20		
A.5	Kompozitorët 14 x 15 lekë / person	210			210		
A.6	Autori i tekstit 16 x 5 lekë / person	80			80		
A.7	Orkestrimi 14x10 leke/per kenge	140			140		
A.8	Ndricues fonist 1 x 100 lekë / person	100			100		
A9	Libretist 1x10 leke/per person	10			10		
A.10	Drejtuës organizativ 1x100 leke	100			100		
A.11	Prezantues 1x10 leke	10			10		
	Shuma	750			750		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
Mbështetje shkolla “Prenk Jakova”		750			750		
	Shuma	750			750		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
Mbështetje shkolla “Prenk Jakova”		750			750		
	Shuma	750			750		
f)Periudha e zbatimit			g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
2026,2027,2028			Drejtoria arsimit Bashkia Shkodër Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër				

		P.AI141.Q1.O3.A2 Instalimin e impianteve fotovoltaike shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda”, “Solo Halili” dhe “Ndoc Mazi		AI141. Arsimi		
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
Bashkia Shkodër ka lidhur marrëveshje që ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Fondacionit në funksion të zbatimit të projektit “Sunny Schools” i cili synon angazhimin e Fondacionit dhe Bashkisë për kryerjen e një investimi, me qëllim instalimin e impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) mbi ndërtesat e shkollave publike “Ndre Mjeda”, “Solo Halili” dhe “Ndoc Mazi”. Energjia elektrike që do të prodhohet nga këto impiante do të përdoret nga Bashkia Shkodër me qëllim uljen e konsumit të saj të përgjithshëm nga rrjeti publik i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) duke krijuar kështu një kursim direkt në faturat e energjisë elektrike.						
ii.Synimi i projektit						
- Të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve të mësuesve të shkollave dhe komunitetit për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe reagimit ndaj ndryshimeve klimaterike. - Të promovojë këtë investim, si mundësi dhe model i ri zhvillimi në punën me institucionet shtetërore dhe donatorët e tjerë						
iii.Aktivitetet kryesore të projektit						
- Të koordinojë procesin me shkollat objekt të marrëveshjes për të rregulluar kushtet dhe mënyrën e transferimit të fondit/ose kryerjes së investimit në shkollat e përfshira bazuar në kursimin nga fatura e energjisë dhe përcaktimin e përgjegjësisë të shkollës në administrimin e fondit të kursyer, parandalimin e shpërdorimit të energjisë dhe mbajtjes së komunikimit me komunitetin shkollor në funksion të zbatimit të projektit. - Palët angazhohen që t'i zgjidhin mosmarrëveshjet vetëm e ekskluzivisht me mirëkuptim nëmbështetje të interesit më të lartë publik e shoqëror - Të koordinojë procesin me shkollat objekt të marrëveshjes për të rregulluar kushtet dhe mënyrën e transferimit të fondit/ose kryerjes së investimit në shkollat e përfshira bazuar në kursimin nga fatura e energjisë dhe përcaktimin e përgjegjësisë të shkollës në administrimin e fondit të kursyer, parandalimin e shpërdorimit të energjisë dhe mbajtjes së komunikimit me komunitetin shkollor në funksion të zbatimit të projekti						
b)Rezultatet që prisni						
- Të angazhohet që investimi të sigurojë standard të lartë teknik dhe të vendosë në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara informacion të plotë mbi investimin e kryer. - Të promovojë këtë investim, si mundësi dhe model i ri zhvillimi në punën me institucionet shtetërore dhe donatorët e tjerë.						
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontribute te mundshme në projekt		
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së ObjektevePublike, Bashkia Shkoder Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - OSFA				Bashkia Shkodër, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - OSFA		
e)Shpenzime te llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
	Instalimin e impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore), shkolla 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda					
	Instalimin e impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore), shkolla 9-vjeçare publike “Solo Halili”					
	Instalimin e impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore), shkolla 9-vjeçare publike Ndoc Mazi					
f)Periodha e zbatimit		g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
2026,2027,2028		Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Bashkia Shkoder				
		Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike				

P.AI141.Q1.O3.A1. Rikonstruksion i godinave shkollore

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit të projektit	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	Firma e propozuesit të Projektit	AI141. Arsimi
Të dhëna të detajuara për Propozuesin e projektit			
Institucioni Buxhetor Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkodër	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02. Identifikimi i Idesë së Investimit

Projekt Idea	Rikonstruksion i pjesshëm Shkollash
Problemet për tu adresuar	Lagështira në ambientet e brendshme të godinës. Dëmtimi dhe amortizimi i suvatimeve të godinës. Amortizimi i bojës së brendshme dhe të jashtme të godinës. Mungesa e rrjetit LAN në çdo klasë. Mungesa e rrjetit të ngrohjes në shkollë. Rrezikshmëria e përdorimit të rrjetit elektrik ekzistues. Dëmtimi i pjesshëm i disa dritareve dhe dyerve. Pamundësia e aksesimit në godinë nga PAK (Personat me aftësi të kufizuara). Mungesa e një sinjalistike për MNZ (Mbrojtjes ndaj zjarrit). Mungesa e një shkalle për MNZ.
Emri i Programit	Arsimi bazë
Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen	Përshtatja e godinës për rastet e emergjencave dhe evakuimeve Krijimi i një ambienti të shëndetshëm me largimin e lagështirës nga godina. Krijimi i një ambienti më të sigurtë për fëmijët dhe arsimtarët me sistemin e MNZ (mbrojtjes ndaj zjarrit). Krijimi i një ambienti të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara. Krijimi i një ambienti konform ligjeve dhe standardeve kombëtare për mësimdhënie, ngrohje. Instalimi i rrjetit LAN në çdo klasë Instalimi i rrjetit të ngrohjes

0.3.Kostot e Projektit të Investimit

	Totali	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Kosto e zbatimit	10,000			10,000
Kosto supervizim				
Kosto kolaudim				
KostoTotale e Projektit-000/lekë	10,000			10,000

04.Autorizuesit/Hapat e aprovimit të projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i ProjektitIdesë
Drejtuesi i Programit në Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuarmetej
Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s.ka) Institucioni Likuidues: Drejtoria Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Investimi do të realizohet: Në vitin 2028				
Sekretari i Përgjithshëm				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projektidesë
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (n.q.s. ka)				

P.A141.Q1.O3.A2. Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli"

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Firma e propozuesit te Projektit	
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit	dpmop@bashkiashkoder.gov.al		
Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkodër	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02. Identifikimi i Idesë se Investimit

Projekt Idea	Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli"
Problemet për tu adresuar	Gjendja aktuale e ndërtesës së kopshtit "Ton Alimhilli" tregon nevojën urgjente për një rikonstruksion të plotë dhe modernizim, pasi infrastruktura e saj nuk përmbush kërkesat bashkëkohore për sigurinë, komoditetin dhe efikasitetin energjetik. Mungesa e Hapësirave të Përshtatshme për Fëmijët dhe Prindërit Problematika me Ambientet e Pushimit dhe Komoditetin e Fëmijëve Ajrimi dhe ndriçimi Sistemi i Ngrohjes dhe Ftohjes
Emri i Programit	Al141 Arsimi
Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen	Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe të sigurta për fëmijët, për të garantuar që ata mund të frekuentojnë kopshtin në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme. Ky rikonstruksion i plotë është një mundësi për të modernizuar dhe përmirësuar infrastrukturën e kopshtit, duke ofruar një ambient të sigurt, komod dhe efikas energjetikisht, që do të kontribuoni në zhvillimin e fëmijëve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për prindërit dhe stafin. Kjo do të ishte një investim i rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve dhe komunitetit. Rikonstruksioni do të synojë të krijojë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e fëmijëve në aspekte të ndryshme, duke përfshirë edukimin, aktivitetet fizike dhe ato rekreative. Krijimi i hapësirave të përshtatshme për aktivitete të ndryshme që stimulojnë zhvillimin e shkathtësive sociale, kreative dhe fizike të fëmijëve. Ky projekt rikonstruksioni do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të edukimit për fëmijët, duke i ofruar atyre një ambient të sigurt, të ngrohtë dhe të përshtatshëm për zhvillimin e plotë të potencialeve të tyre. Rikonstruksioni do të përfshijë mjediset e brendshme dhe të jashtme të këtij kopshti sipas standardeve të ndërtimit të objekteve të tilla duke e rikonceptuar si një mjedis multifunksional e rekreativ që nxit zhvillimin e fëmijëve.

0.3. Kostot e Projektit te Investimit

Rikonstruksion "Kopshti Ton Alimhilli"			
Kostot e Projektit te Investimit/lek			
	Totali	Viti 2026	Viti 2027
Kosto e zbatimit	4,599,624	4,599,624	
Kosto supervizim			
Kosto kolaudim			
Kosto Totale e Projektit- lekë	4,599,624	4,599,624	
Kostot e Projektit te Investimit te miratuara per akordim nga MAS / lek			
	Totali	Viti 2026	Viti 2027
Kosto e zbatimit			

Kosto supervizim			
Kosto kolaudim			
Kosto Totale e Projektit- lekë			
Kostot e Projektit te Investimit / lek - Financim nga NJQV			
	Totali	Viti 2026	Viti 2027
Kosto e zbatimit	4,599,624	4,599,624	
Kosto supervizim			
Kosto kolaudim			
Kosto Totale e Projektit- lekë	4,599,624	4,599,624	

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit Idesë</i>
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka) Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder Investimi do të realizohet: Faza dyte në vitin 2026 në shumën 4,599,624 lekë				
				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idesë

P.AI141.Q1.O3.A3. Rikonstrukcion dhe ndërtim palestere Shkolla e hapur "Ismail Qemali"

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	Firma e propozuesit te Projektit	
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit	dpmop@bashkiashkoder.gov.al		
Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkodër	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02. Identifikimi i Idesë se Investimit

Projekt Idea	Shkolla e Hapur "Ismail Qemali"
Problemet për tu adresuar	Muret dhe suvatimet janë të amortizuara dhe kërkojnë riparime. Dyert dhe dritaret janë të dëmtuara dhe mund të mos ofrojnë efikasitetin energjetik të kërkuar. Ambjentet e përbashkëta janë të paafte të përmbushin kërkesat për zhvillimin e aktiviteteve arsimore dhe rekreative. Ndërtesa nuk i përmbush standardet e sigurisë dhe komoditetit për arsimin 9 vjeçar, që mund të ndikojë negativisht në përvojën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Klasat dhe ambjentet e përbashkëta kërkojnë rinovim për të krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve të tjera. Nevoja për ndërhyrje të sistemeve të sinjalistikës dhe Mbrojtjes nga Zjarri (MNZ) për të krijuar një sistem funksional dhe të sigurt. Objekti nuk është i përshtatshme për PAK, duke përfshirë rampa hyrëse që janë jashtë standardeve. Tualetet janë të dëmtuara dhe nuk përmbushin kërkesat për përdorim nga PAK. Rrjeti elektrik ka nevojë për rinovim për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe efikas. Godina është e paisur me Kaldajë me naftë dhe duhet integruar me projektin e rikualifikimit.
Emri i Programit	AI 141 Arsimi
Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen	Ndërhyrje të sistemeve të sinjalistikës dhe Mbrojtjes nga Zjarri (MNZ) për të krijuar një sistem funksional dhe të sigurt. Ndërhyrje do të ketë edhe në rrjetet elektrike duke realizuar rrjetin e brendshëm dhe të jashtëm të ndricimit. Rrjeti hidraulik gjithashtu do të ketë instalime të reja. krijimin e një hapësire funksionale dhe tërheqëse, që jo vetëm përmirëson mjedisin arsimor, por edhe kontribuon në forcimin e lidhjeve sociale dhe komunitare. Krijimi i klasave moderne dhe fleksibile që mund të përshtaten për metoda mësimdhënieje të ndryshme (grupore, individ, aktivitete praktike, etj.). Sigurimi i kushteve për mësim të përshtatshëm, me hapësira të ajrosura dhe të ndriçuara mirë, që ndihmojnë në përqëndrimin e nxënësve dhe rritin produktivitetin e mësimin. Përdorimi i materialeve moderne dhe efikase për ngrohje dhe ftohje, për të garantuar një ambient komod gjatë gjithë vitit. Ndërtimi i palestrës së mbyllur dhe mjediseve të laboratorëve.

0.3. Kostot e Projektit te Investimit

Shkolla e hapur "Ismail Qemali"				
Kostot e Projektit te Investimit / lek				
	Totali	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Kosto e zbatimit	29,980,622	29,980,622		
Kosto supervizim				
Kosto kolaudim				
Kosto Totale e Projektit- 000/lekë	29,980,622	29,980,622		

Kostot e Projektit te Investimit te miratuara per akordim nga MAS / lek				
	Totali	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Kosto e zbatimit				
Kosto supervizim				
Kosto kolaudim				
Kosto Totale e Projektit- lekë				
Kostot e Projektit te Investimit / lek - Financim nga NJQV				
	Totali	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Kosto e zbatimit	29,980,622	29,980,622		
Kosto supervizim				
Kosto kolaudim				
Kosto Totale e Projektit- lekë	29,980,622	29,980,622		

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt ides

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit Idesë</i>
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka) Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder Investimi do të realizohet: faza e dytë në vitin 2026 në shumën 29,980,622 lekë				
				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idesë

P.A1141.Q1.O3.A4. "Shtese dhe sistem kapote Shkolla Shtoj i Ri"

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	Firma e propozuesit te Projektit	Programi A1141 : Arsimi P.A1141.Q1.O3.A9 Shtese dhe sistem kapote shkolla Shtoj i Ri
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit			
Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkoder	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02. Identifikimi i Idesë se Investimit

Projekt Idea	Rikonstruksion Shkolla Shtoj i Ri
Problemet për tu adresuar	Shkolla zhvillon mësim në dy turne për shkak të mungesës së klasave të mjaftueshme, gjë që vështirëson organizimin e procesit mësimor, kufizon aktivitetet jashtëshkollore dhe ndikon negativisht në përqendrimin e nxënësve, veçanërisht në turnin e dytë. Gjithashtu, godina nuk është e termoizoluar, çka sjell humbje të mëdha energjie, kushte të pakëndshme termike në dimër dhe verë, si dhe kosto të larta për ngrohje dhe ftohje. Këto faktorë ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimin dhe mirëqenien e nxënësve.
Emri i Programit	Arsimi Baze
Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen	Projekti synon ndërtimin e një shtese për të siguruar mjaftueshëm klasa dhe për të kaluar në një sistem mësimi me një turn, duke përmirësuar ndjeshëm organizimin dhe cilësinë e procesit mësimor. Gjithashtu parashikohet termoizolimi i godinës, me qëllim përmirësimin e kushteve të brendshme, uljen e konsumit të energjisë dhe krijimin e një ambienti modern, efikas dhe të sigurt për nxënësit dhe stafin

0.3. Kostot e Projektit te Investimit

	Total	Viti 2026
Kosto Totale e Projektit leke	1,102,965	1,102,965
Kosto e Zbatimit		
Kosto e Mbikëqyrjes		
Kosto Kolaudim		
Kosto Projektim	1,102,965	1,102,965

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idesë
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka) Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike				
Sekretari i Pergjithshem				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idese
Komente nga Sekretari i Pergjithshem (nqs ka)				

P.AI141.Q1.O3.A5 "Shtese dhe sistem kapote shkolla Xheladin Fishta"

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	Firma e propozuesit te Projektit	Programi AI141 : Arsimi P.AI141.Q1.O3.A10 Shtese dhe sistem kapote shkolla Xheladin Fishta
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit			
Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkoder	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02. Identifikimi i Idesë se Investimit

Projekt Idea	Shtese dhe sistem kapote shkolla Xheladin Fishta
Problemet për tu adresuar	Shkolla aktualisht zhvillon mësim në dy turne për shkak të mungesës së hapësirave të mjaftueshme mësimore. Ky organizim krijon një sërë problematikash që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e procesit arsimor. Mësimi në dy turne redukton kohën efektive të përdorimit të klasave, ngarkon orarin e nxënësve dhe mësuesve, si dhe e vështirëson organizimin e aktiviteteve jashtëshkollore, punëve praktike dhe orëve plotësuese. Për më tepër, turni i dytë shpesh ndikon negativisht në përqendrimin e nxënësve për shkak të lodhjes së ditës dhe kushteve të pafavorshme të ndriçimit natyror. Një problem tjetër thelbësor është mungesa e termoizolimit të godinës. Shkolla përballlet me humbje të konsiderueshme të energjisë, duke rritur dhe kostot e Bashkise Shkoder
Emri i Programit	Arsimi Baze
Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen	Projekti i planifikuar ka si objektivi kryesor përmirësimin e infrastrukturës arsimore përmes shtimit të hapësirave të reja mësimore dhe termoizolimit të plotë të godinës ekzistuese. Shtesa e godinës synon të krijojë një numër të mjaftueshëm klasash për të eliminuar mësimin me dy turne dhe për të garantuar zhvillimin e procesit arsimor vetëm në një turn. Kjo do të lehtësojë oraret e nxënësve dhe mësuesve, do të rrisë kohën e disponueshme për veprimtari mësimore dhe jashtëshkollore, si dhe do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies. Termoizolimi i godinës ekzistuese dhe i shtesës së re synon të sigurojë një mjedis termik të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit. Projekti parashikon izolimin e mureve të jashtme, çatisë dhe ndërrimin e dritareve me sisteme efikase energjetike. Ky investim do të ulë ndjeshëm humbjet e energjisë, do të krijojë kushte optimale të të nxënësve dhe do të reduktojë shpenzimet e shkollës për ngrohje dhe ftohje. Përmirësimi i performancës energjetike të godinës është gjithashtu në përputhje me standardet moderne të efikasitetit energjetik dhe me praktikën e qëndrueshme të ndërtimit. Synimi përfundimtar i projektit është krijimi i një mjedisi arsimor të sigurt, modern dhe funksional, i cili ofron kushte cilësore për zhvillimin e procesit mësimor. Zbatimi i këtij projekti do të ndikojë pozitivisht tek nxënësit, mësuesit dhe komuniteti, duke garantuar një shkollë të përshtatshme për nevojat aktuale dhe sfidat e së ardhmes. Perfitues te projektit do te jene me shume se 450 nxenes dhe mesues

0.3. Kostot e Projektit te Investimit

	Total	Viti 2026
Kosto Totale e Projektit leke	1,975,884	1,975,884
Kosto e Zbatimit		
Kosto e Mbikëqyrjes		
Kosto Kolaudim		
Kosto Projektim	1,975,884	1,975,884

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idesë
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka) Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike				
Sekretari i Përgjithshem				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idese
Komente nga Sekretari i Përgjithshem (nqs ka)				

P.AI141.Q1.O3.A6 "Projektim Rikonstruksione Shkolla"

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	Firma e propozuesit te Projektit	Programi AI141: Arsimi P.AI141.Q1.O3.A11 Projektim Rikonstruksione Shkolla
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit			
Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkoder	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02. Identifikimi i Idesë se Investimit

Projekt Idea	Projektim rikonstruksione shkolla
Problemet për tu adresuar	Bashkia e konsideron ten je rendesie paresore pajisjen me projekte cilësore për shkollat, çka e pengon sigurimin e fondeve dhe vonon investimet në infrastrukturën arsimore. Shumë institucione kanë nevojë urgjente për rikonstruksion, zgjerim dhe përmirësim të kushteve, por pa dokumentacion teknik të përgatitur siç duhet, mundësitë për financim humben. Duke qenë se arsimi është një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të komunitetit, siguria dhe cilësia e shkollave janë thelbësore. Prandaj, përgatitja e projekteve të standardizuara është kusht i domosdoshëm për të përfituar fonde dhe për të garantuar një mjedis më të mirë mësimor për fëmijët.
Emri i Programit	Arsimi
Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen	Projekti do të ndihmojë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Programit duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe krijimin e kushteve më të sigurta e bashkëkohore për nxënësit dhe stafin. Përgatitja e projekteve të plota dhe të standardizuara do t'i mundësojë bashkisë të aplikojë me sukses për fonde publike dhe donatorë, duke përshpejtuar investimet e nevojshme në shkolla. Në këtë mënyrë, projekti mbështet rritjen e cilësisë së arsimit, përmirësimin e kushteve mësimore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit përmes shkollave më funksionale dhe më efikase energjetikisht.

0.3. Kostot e Projektit te Investimit

	Total	2026
Kosto Totale e Projektit leke	11,800,000	11,800,000
Kosto e Zbatimit		
Kosto e Mbikëqyrjes		
Kosto Kolaudim		
Kosto Projektim	11,800,000	11,800,000

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idesë
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka) Institucioni likuidues: Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike				
Sekretari i Pergjithshem				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idese
Komente nga Sekretari i Pergjithshem (nqs ka)				

Nr.39	P.AI141.Q2.O1.A1. Mbështetje për punonjësit e shërbimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm	AI141. Arsimi				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet t'i mundësojë të gjithë fëmijëve që të kenë rezultate në mësim, të jenë të sigurtë, të shëndetshëm dhe aktivë në jetën komunitare. Bashkia e Shkodrës duhet të sigurojë mirëfunksionimin e një numri të madh institucioneve që kërkojnë një vëmendje të veçantë. Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", shkresën nr. 11166, datë 24.12.2015, në lidhje me procedurat e transferimit të punonjësve si dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve për personelin për pagat e punonjësve që transferohen nga Ministria e Arsimit e Sportit tek Njësitë e Qeverisjes Vendore (bashkitë e reja) si dhe në transfertë specifike parashikuar në Ligjin për Buxhetin e Shtetit. Llogaritja e pagave për vitin 2026 është mbështetur në bazë të V.K.M nr. 422, datë 26.06.2024, "Për një ndryshim në vendimin nr. 326, dt. 31.05.2023, për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike". Planifikimi i pagave është mbështetur dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 113, datë 01.03.2023, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi". Shërbimi në arsimin e mesëm (stafi mbështetës) financohet për paga dhe sigurime shoqërore.						
ii.Synimi i projektit						
Mbështetje e funksionimit të shkollave në Bashkinë Shkodër për të gjithë personelin mbështetës.						
iii.Aktivitetet kryesore të projektit						
Kryerje e rregullt e pagesave për paga,sigurime shoqërore dhe shëndetësorë të punonjësve,nëmbështetjetë pëmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm,korrektësi dhe transparence.						
b)Rezultatet që prisni						
Çdo punonjës sipas pozicionit të punës të shërbejë,të japë rezultate pozitive duke zbatuar ligjin,vendimet e Bashkisë dhe urdhërat e titullarit të institucionit.						
c)Aktorët e mundshëm			d)Kontributet e mundshme në projekt			
Shteti			Bashkia e Shkodrës			
e)Shpenzime te llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali(mijëlekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferim
A.1	Punonjës mbështetës në Arsimin e mesem përgjithshëm	5,171	4,461	710		
	Shuma	5,171	4,461	710		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali(mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferim
A.1	Punonjës mbështetës në Arsimin e mesem përgjithshëm	5,171	4,461	710		
	Shuma	5,171	4,461	710		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali(mijë lekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferim
A.1	Punonjës mbështetës në Arsimin e mesem përgjithshëm	5,171	4,461	710		
	Shuma	5,171	4,461	710		
f)Periodha e zbatimit		g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Arsimit Bashkia Shkodër Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër				
2026,2027,2028						

Nr.40	P.A1141.Q2.O1.A2. Mbështetje për punonjësit e arsimit të mesëm profesional.		A1141. Arsimi				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i.Situata							
